EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5726
E premte, 15 mars 2019
çmimi 0.40 €

Kosnett: Kosova ka ngecur në luftimin e korrupsionit

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MAZLLUM BARALIU FAQE 4-5

Nuk mund të ketë zgjedhje të reja pa funksionalizimin e KQZ-së

Njohësi i proceseve zgjedhore në vend, Mazllum Baraliu, ka ftuar subjektet politike të reflektojnë rreth funksionalizimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se nuk mund të ketë zgjedhje të parakohshme nëse nuk funksionalizohet ky institucion. Baraliu ka thënë se funksionalizimi i KQZ-së duhet të ndodhë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, është koha që presidenti i vendit t'i ftojë partitë politike në një tryezë nga e cila do të gjendej një zgjidhje për ta kompletuar KQZ-në

APOSTOLOVA THOTË SE TAKSA PO PENGON AGJENDËN E REFORMAVE EVROPIANE TË KOSOVËS

FAQE 7

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalyia Apostolova, ka thënë të enjten se publikimi i Agjendës për Reforma Evropiane, ERA 2, po pengohet për shkak të vendosjes së taksës 100 për qind nga ana e Qeverisë së Kosovës për produktet e Serbisë dhe të Bosnje e Hercegovinës. "Ne jemi në fillimin e lansimit të ERA 2 dhe mendoj se do të bëjmë një ceremoni kur kushtet politike të jenë të favorshme. Po flas për tarifat e vendosura të cilat po na pengojnë për vazhdimin e procedurave", ka deklaruar Apostolova

FAQE 6

Ministri Gashi kërkon më shumë linja ajrore për bashkatdhetarët

Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur të enjten në takim drejtorin e operacioneve të Aeroports de Lyon që ka në menaxhim Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës " Adem Jashari", Jamel Ladhari, me të cilin ka diskutuar për hapjen e linjave të reja ajrore për bashkatdhetarët tanë që do t'i minimizonin kostot e biletave për të cilat diaspora e Kosovës tashmë disa vjet ankohet se janë të larta.

AKTUALE

OPOZITA E KOSOVËS, VEÇ 'NJË TIGËR PREJ LETRE' F. 8

Fadil MALOKU

MJEKË KARDIOKIRURGË NGA ITALIA PO OPEROJNË PACIENTË NË QKUK F. 6

ZËVENDËSMINISTRJA VUNIQI KËRKON MBËSHTETJEN E BAVARISË PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE F. 7

EKONOMI

VESELI FTON INVESTITORËT NGA JAPONIA TË INVESTOJNË NË KOSOVË F. 9

MBËSHTETJA E BE-së PËR MTI-në, SHUMË E NEVOJSHME F. 8

KULTURË

KËTË MUAJ NË TIRANË DO TË NËNSHKRUHET KALENDARI I PËRBASHKËT KOSOVË - SHQIPËRI F. 11

SPORT

SAHITI: VËLLAZNIMI SYNON SUPERLIGËN DHE KUPËN F. 12

CHALLANDESI PUBLIKOI LISTËN PËR NDESHJET NDAJ DANIMARKËS DHE BULLGARISË F. 12

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi dhe Moor bisedojnë për dialogun dhe tarifën

Beograd, 14 mars - Britania e Madhe, pavarësisht prej daljes së planifikuar nga BE-ja, do të mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar dhe mbështetur rajonin e Ballkanit. Këtë e konfirmoi në Beograd drejtori i përgjithshëm për çështje politike në Ministrinë e Jashtme të Britanisë së Madhe, Richard Moor, pas takimit me presidentin Aleksandar Vuçiq.

Zyrtari i lartë britanik tha se gjatë qëndrimit që kishte në Kosovë, para se të udhëtonte për në Beograd, ka kërkuar nga autoritetet e Prishtinës ta shfuqizojnë tarifën ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjës në mënyrë që të dyja palët sa më parë ta vazhdojnë dialogun, thuhet në një komunikatën për media nga zyra e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Dialogu që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është bllokuar që prej se Kosova vendosi taksën doganore prej 100 përqindësh.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në bisedë me zyrtarin britanik ka shfaqur shpresën së bashkësia ndërkombëtare do të vazhdojë t'i bëjë thirrje Prishtinës të heqë dorë nga taksa.

Raporti i DASh-it: Politikanë, gjyqtarë dhe zyrtarë shmangin dënimin në Shqipëri

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit mbi të drejtat e njeriut në botë, në pjesën për Shqipërinë trajtohen një numër çështjesh e ku, ndër të tjera, thuhet se zyrtarët, politikanët, gjyqtarët dhe personat me interesa të fuqishme biznesi shpesh ishin në gjendje ta shmangnin ndjekjen penale

Tiranë, 14 mars - Departamenti Amerikan i Shtetit publikoi raportin mbi të drejtat e njeriut në botë. Në pjesën për Shqipërinë trajtohen një numër çështjesh. Mosndëshkimi mbeti problem. Ndjekja penale, sidomos dënimi i zyrtarëve që kryenin abuzime, ishte sporadik dhe jokonsistent. Zyrtarët, politikanët, gjyqtarët dhe personat me interesa të fuqishme biznesi shpesh ishin në gjendje ta shmangnin ndjekjen penale. Në përgjigje të kësaj, autoritetet kanë ndërmarrë një veting të monitoruar ndërkombëtarisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kanë shkualifikuar një numër të konsiderueshëm zyrtarësh për pasuri të pashpjegueshme ose lidhje me krimin e organizuar.

Korrupsioni vazhdoi të ishte një problem serioz në qendrat e paraburgimit.

Edhe pse qeveria ka mekanizma për të hetuar dhe dënuar abuzimin dhe korrupsionin, korrupsioni në radhët e policisë mbeti problem.

Media e pavarur ishte aktive dhe shprehu një larmi pikëpamjesh, megjithëse pati përpjekje për të ushtruar presion politik dhe ekonomik të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë mbi medien, duke përfshirë kërcënimet dhe dhunë ndaj gazetarëve që u përpoqën ta hetonin krimin dhe korrupsionin. Pronarët e bizneseve kanë përdorur lirshëm mediet për të përfituar favore dhe për t'i promovuar interesat e tyre pranë partive politike. Shumica e pronarëve të televizioneve private përdorën transmetimet e tyre për të ndikuar në veprimet e Qeverisë ndaj bizneseve të tjera të tyre.

Presioni politik, korrupsioni dhe mungesa e fondeve kufizuan mediet e pavarura të shtypit. Gazetarët besohet se praktikuan vetëcensurimin. Pasiguria ekonomike për shkak të mungesës së kontratave të detyrueshme të punës uli pavarësinë e gazetarëve dhe kontribuoi në anshmërinë e raportimeve. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë vazhdoi të raportojë vonesa të mëdha në pagesat e pagave për gazetarët në shumicën e medieve, në disa raste deri në 10 muaj. Problemet financiare i kanë bërë disa gazetarë që të mbështeten më shumë në burimet e jashtme të të ardhurave, duke ngritur pyetje të integritetit.

OJQ-të pohuan se etika profesionale ishte një prioritet i ulët për disa nga portalet, që vlerësohet se arrijnë në rreth 700, duke ngritur shqetësime rreth përhapjes së lajmeve të rreme në përfitim të interesave të veçanta financiare ose politike. Rritja dramatike e medieve në internet solli një larmi pikëpamjesh.

Kriza ekonomike dhe praktikat e menaxhimit në mediet shqiptare ka pakësuar financat dhe cilësinë e raportimit në media. Ka pasur raporte të shumta për dhunë dhe kërcënime ndaj anëtarëve të medieve, ndërkohë që interesat politike dhe të biznesit i vunë gazetarët në presion.

Më 30 gusht, një person i panjohur qëlloi 10 herë në shtëpinë e prindërve të reporteres së krimit Klodiana Lala. Lala raporton shpesh për krimin e organizuar dhe çështjet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë reformën gjyqësore.

Në shtator, kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë deklaroi se 12 gazetarë kishin paraqitur kërkesa për azil në vendet anëtare të BE-së, duke përmendur kërcënime për shkak të vendeve të tyre të punës.

Gazetarët shpesh praktikojnë vetëcensurim për të shmangur dhunën dhe ngacmimin dhe si reagim ndaj presionit nga botuesit dhe redaktorët që kërkojnë të avancojnë interesat e tyre politike dhe ekonomike.

Autoriteti për Komunikimet Elektronike dhe Postare dekretoi më 15 tetor se 44 portale të medieve kishin 72 orë për të marrë një numër identifikimi tatimor dhe ta publikonin në faqet e tyre të internetit ose qeveria do t'i mbyllte ato. Lista përfshiu disa faqet e lajmeve hulumtuese, duke përfshirë BIRN. Deri në fund të vitit, qeveria nuk i kishte mbyllur portalet që nuk kishin marrë numrin e identifikimit tatimor.

PD: DASh-i konfirmoi blerjen e votave nga Qeveria

Tiranë, 14 mars - Sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, reagoi në lidhje me raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit. Në dy postime të njëpasnjëshme në "Twitter", Bardhi u shpreh se raporti i DASh-it konfirmoi blerjen e votave në 2017, ndërsa u bëri thirrje qytetarëve që t'i bashkohen protestës së opozitës në 16 mars. "Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit konfirmon blerjen e votave në 2017 dhe nivelin e lartë të korrupsionit të Qeverisë së Edi Ramës. Askush nuk ndëshkohet! Kundër blerjes së votave, kundër pandëshkueshmërisë, kundër korrupsionit. Shqiptarët do të bashkohen më 16 mars!", tha Bardhi.

Duke cituar DASh-in, Bardhi akuzon Qeverinë se nuk ka zbatuar ligjin dhe se është përfshirë nga korrupsioni. "Ligji parashikon ndëshkime penale për korrupsion për zyrtarët publikë, por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive dhe zyrtarët shpesh u angazhuan në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha degët e qeverisë", tha sekretari i përgjithshëm i PD-së.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Publikohet raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në botë për vitin 2018, Kosova kritikohet për korrupsion dhe dëbim të shtetasve turq

Kosnett: Kosova ka ngecur në luftimin e korrupsionit

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Philip Kosnett, ka kritikuar shtetin e Kosovës për ngecje në luftimin e korrupsionit. Ai ka thënë se Kosova vazhdon të frenohet nga korrupsioni, sulmet kundër gazetarëve, dëbimi i shtetasve të huaj pa një proces të rregullt dhe dhuna kundër pakicave. Këto komente diplomati amerikan Kosnett i ka bërë pas publikimit të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në botë në vitin 2018

PRISHTINË, 14 MARS - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Philip Kosnett, të enjten është shprehur i pakënaqur me dinamikën e shtetit të Kosovës në luftimin e korrupsionit. Ai ka vlerësuar se Kosova vazhdon të frenohet nga korrupsioni, sulmet kundër gazetarëve, dëbimi i shtetasve të huaj pa një proces të rregullt dhe dhuna kundër pakicave.

Diplomati amerikan këto komente i ka bërë pas publikimit të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në botë për vitin 2018. "Raporti 2018 për të drejtat e njeriut. Një hap përpara që merret me miratimin dhe rishikimin e Kodit Penal. Kosova vazhdon të frenohet nga korrupsioni, sulmet ndaj gazetarëve, dëbimi i shtetasve të huaj pa proces të rregullt dhe dhuna ndaj pakicave", ka shkruar Kosnett në llogarinë e vet në "Twitter".

Për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut ka folur edhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi. Ai ka thënë se ky raport ka identifikuar shumë përparime në sektorin drejtësisë, por edhe shumë sfida që kemi përpara. Thaçi ka deklaruar se të gjitha ngecjet që janë identifikuar në këtë raport duhet të merren seriozisht nga institucionet e Kosovës dhe të punohet me dinamikë më të madhe për përmirësimin e tyre. Sipas tij, Kosova duhet ta vazhdojë luftën e pakompromis kundër korrupsionit. "Raporti për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2018, i publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, ka identifikuar shumë përparime në sektorin drejtësisë, por edhe shumë sfida që kemi përpara. I jemi mirënjohës ShBA-së për investimet dhe mbështetjen që i ka dhënë Kosovës në sektorin e drejtësisë. Të gjitha ngecjet që janë identifikuar në këtë raport duhet të merren seriozisht nga institucionet e Kosovës dhe të punohet me dinamikë më të madhe për përmirësimin e tyre. Ne duhet ta vazhdojmë luftën e pakompromis kundër korrupsionit dhe t'i garantojmë të drejtat e qytetarëve të të gjitha komuniteteve tona, si vlera mbi të cilat e kemi ndërtuar shtetin tonë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e tij në "Facebook".

Ndërsa raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në botë për vitin 2018, në pjesën për Kosovën, ka identifikuar si probleme kryesore kthimin e detyrueshëm të refugjatëve ose azilkërkuesve, korrupsionin endemik në qeveri, kërcënimet e dhunshme kundër gazetarëve dhe sulmet kundër pakicave. Ky raport në veçanti përmend rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi ku, siç thuhet, janë kërkuar nën akuza të paqarta. "OJQ-të dhe Institucioni i Avokatit të Popullit kanë thënë se Qeveria ua ka mohuar të drejtën të të ndaluarve për të kërkuar azil ose për të apeluar vendimin për dëbim para gjykatës. OJQ-të dhe politikanët e opozitës kanë thënë se dëbimi i përshpejtuar ka qenë i motivuar politikisht. Kryeministri (i Kosovës) ka shkarkuar ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës të Kosovës si rezultat i incidentit", është thënë në raport.

Kurse te pjesa për lirinë e shprehjes, raporti ka theksuar se Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës e garantojnë lirinë e shprehjes dhe se Qeveria në përgjithësi e ka respektuar këtë të drejtë. Por, më tutje, është thënë se disa zyrtarë publikë, politikanë, biznesmenë dhe grupe radikale fetare kanë bërë përpjekje t'i frikësojnë përfaqësuesit e medieve. "Mediet, gjithashtu, hasën në vështirësi për marrjen e informacionit nga Qeveria dhe institucionet publike, ashtu siç parashihet me ligj", është theksuar në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Po në këtë raport është cekur se Qeveria nuk e ka zbatuar ligjin në mënyrë efektive për zyrtarët që kryejnë vepra korruptive. "Zyrtarët, nganjëherë, janë angazhuar në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit kanë kontribuar në këtë problem", është theksuar në raport. Po sipas këtij raporti, incidentet e sigurisë kanë vazhduar kundër serbëve të Kosovës dhe këtu përmendet rasti i vrasjes së politikanit serb Oliver Ivanoviq.

Përurohet fillimi i punimeve për projektin e furnizimit me ujë në gjashtë fshatra të Kamenicës

KAMENICË, 14 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, bashkë me ministrin e Financave, Bedri Hamza, kanë bërë përurimin e punimeve për furnizimin me ujë në fshatrat Hodonoc, Roganë, Novosellë, Muqivërc, Dajkoc dhe Shipashnicë të Poshtme.

Projekti për furnizimin me ujë përfshinë puset, stacionin e pompimit (pompat që dërgojnë ujin në rezervuar dhe trafon), rezervuarin me vëllim V=1000 m3 dhe rrjetin shpërndarës në këto fshatra rreth 35 kilometra.

Kryetari Kastrati ka thënë se ky projekt është shumë i rëndësishëm për 25 për qind të banorëve të Kamenicës dhe se i është mirënjohës ministrit Hamza për përkrahjen e vazhdueshme.

Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (SDC), Qeveria e Kosovës - Ministria e Financave dhe komuna, projekt ky i cili ka vlerën prej 883.056.00 eurosh.

Flet për "Epokën e re", Mazllum Baraliu

Nuk mund të ketë zgjedhje të reja

Njohësi i proceseve zgjedhore në vend, Mazllum Baraliu, ka ftuar subjektet politike të reflektojnë rreth funksionalizimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se nuk mund të ketë zgjedhje të parakohshme nëse nuk funksionalizohet ky institucion. Baraliu ka thënë se funksionalizimi i KQZ-së duhet të ndodhë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, tani është koha që presidenti i vendit t'i ftojë partitë politike në një tryezë nga e cila do të gjendej një zgjidhje për ta kompletuar KQZ-në

EPOKA E RE Muhamet KOCI

Prishtinë, 14 mars - Njohësi i proceseve zgjedhore në vend, Mazllum Baraliu, ka bërë me dije se nuk mund të ketë zgjedhje të reja pa funksionalizimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Ai i ka ftuar të gjitha subjektet politike që të reflektojnë për këtë çështje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Baraliu ka deklaruar se funksionalizimi i këtij institucioni është interes shtetëror. "Nuk mund të ketë zgjedhje të reja pa funksionalizim të KQZ-së. Ne tani kemi një paralizë institucionale jo vetëm nga aspekti i zhvillimit të zgjedhjeve, që është kryesorja, sepse KQZ-ja është burim i demokracisë dhe burim i institucioneve të vendit. Kështu që, pa të dhe pa procedurat që zbaton ky institucion për zgjedhjet nuk mund të kemi zgjedhje", ka thënë Baraliu. Ai nuk ka folur se si duhet të jetë përfaqësimi i partive në këtë institucion, por ka thënë se përfaqësimi duhet të jetë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. "Nuk dua të jap ndonjë recetë se si të veprohet, sepse nuk më takon mua, por nëse subjektet politike kanë pretendime reale, atëherë ato do të duhej ta interpretojnë mirë vendimin e kushtetueses, sepse ai vendim është zgjatim i Kushtetutës dhe nenit përkatës. Prandaj, do të duhej që në mënyrë racionale dhe me mirëkuptim racional juridik ta analizojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe ta pranojnë zgjidhjen e cila është e domosdoshme për t'u aplikuar", ka thënë ai. Sipas tij, tani është koha që presidenti i vendit t'i ftojë partitë politike në një tryezë për të gjetur një zgjidhje rreth kësaj çështje.

"Epoka e re": *Z. Baraliu, seanca e Kuvendit të Kosovës, e cila kishte për synim funksionalizimin e KQZ-së, ka dështuar. Subjektet politike kanë shprehur mendime të ndryshme për këtë çështje. Si e keni parë këtë debat parlamentar?*

Baraliu: Fatkeqësisht, edhe këtë debat parlamentar e kam parë si një vazhdimësi e një avazi të vjetër që ka ndodhur edhe në vitet e mëhershme, pra edhe në qeveritë e kaluara. Disa prej institucioneve të pavarura që janë edhe kategori kushtetuese, si KQZ-ja apo bordet e ndërmarrjeve publike, me vite të tëra kanë funksionuar jashtë mandatit ose të pakompletuara. Mosfunksionalizimi i institucioneve të pavarura është një papërgjegjësi e subjekteve politike dhe e institucioneve më të larta të vendit. Kjo është një sëmundje që po na përsëritet, e cila shkakton pasoja të pariparueshme. Siç dihet, KQZ-ja që një vit është jofunksionale dhe nuk ka mundur të marrë asnjë vendim. Ai institucion nuk është vetëm për mbajtjen e zgjedhjeve dhe menaxhimin e tyre, por është institucion edhe për kryerjen e punëve të tjera, për ta sensibilizuar opinionin, për trajnimin e stafit, për kontakt me grupe të ndryshme që të vetëdijesohen dhe të marrin pjesë sa më masivisht në procesin zgjedhor. Pra, kemi të bëjmë me një papërgjegjësi dhe lëshim, i cili, edhe në mbledhjen e Kuvendit, nuk arriti të ketë një epilog të duhur, që të ketë një votim të një rezolute. Nuk është me rëndësi se nga kush është propozuar ajo rezolutë, por të gjitha partitë politike pa dallim, pozitë dhe opozitë, nuk arritën ta votojnë këtë rezolutë dhe të kenë një qëndrim unik, i cili do të ishte në interes të shtetit të Kosovës dhe KQZ-së.

"Epoka e re": *Si ekspert i kësaj çështje, si mendoni se duhet të ndodhë funksionalizimi i këtij institucioni?*

Baraliu: Vetëm me një mirëkuptim që të gjithë duhet ta kenë. Në këtë rast duhet të vijë në shprehje interpretimi i drejtë dhe i saktë i Kushtetutës së Kosovës, ku thuhet se gjashtë anëtarë iu takojnë partive shqiptare, kurse katër anëtarë pakicave të tjetra. Ndërsa kryesuesen e KQZ-së e zgjedh presidenti nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme. Po ashtu, edhe Ligji për zgjedhjet e përgjithshme e saktëson këtë çështje. Është një vendim i Gjykatës Kushtetuese i cili e sqaron këtë çështje. Paqartësitë në vendimmarrjen e presidentit janë shkaktuar për shkak se në zgjedhjet e fundit parlamentare është dashur që brenda afatit ligjor të ndodhë kompletimi i KQZ-së sipas rezultateve zgjedhore. Por, siç dihet, kjo nuk ka ndodhur 60 ditë pas zgjedhjeve, ndërkohë ka ndodhur që renditja e partive politike shqiptare të ndryshojë. Tani nga LV-ja është ndarë një pjesë e deputetëve dhe është formuar një parti tjetër politike, ndërsa tashmë pretendimi i asaj partie është që të ketë një përfaqësues të sajin në KQZ. Ndërsa edhe koalicioni PAN pretendon që të ketë më shumë se dy përfaqësues, derisa vendimi i Gjykatës Kushtetues parasheh

pa funksionalizimin e KQZ-së

që tri grupet më të mëdha parlamentare të marrin nga dy anëtarë në KQZ. Sipas kësaj, ishte dashur që LV-ja, PDK-ja dhe LDK-ja t'i marrin nga dy anëtarë. Koalicionin PAN ligjin e trajton si një subjekt politik dhe ai subjekt politik nuk mund të ketë më shumë se dy anëtarë, kurse tani tri subjektet që përbëjnë koalicionin pretendojnë ta kenë nga një përfaqësues në KQZ. Pra, ka konfuzion dhe paqartësi. Prandaj, Presidenca me të drejtë e ka dërguar këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, e cila këtë kërkesë e ka vlerësuar të papranueshme. Tani partitë politike për herë të dytë i kanë dërguar propozimet e tyre, ndërkohë Presidenca ende nuk ka vendosur.

"Epoka e re": *Në bazë të kësaj që përmendet deri më tani, si do të duhet të vendosë presidenti?*

Baraliu: Zgjidhja do të duhej të ishte kështu. Së pari, presidenti pa vonesë duhet t'i ftojë partitë politike të cilat kanë të drejtë që të jenë të përfaqësuara në KQZ, të diskutojnë në një tryezë në mënyrë që t'i sqarojnë paqartësitë e tyre. Pra, ta analizojnë Kushtetutën dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e pastaj të marrin një qëndrim unik rreth kësaj çështje. Nëse nuk pajtohen, atëherë presidenti e ka në dorë që në funksion të frymës kushtetuese dhe akteve që përmenda më sipër, t'i mandatojë anëtaret e KQZ-së.

"Epoka e re": *Dhe në qoftë se nuk kemi pajtim të partive politike për këtë çështje, çfarë duhet të bëjë presidenti? Nga ajo që kemi parë, dy subjektet më të mëdha opozitare kërkojnë që t'i kenë nga dy përfaqësues në KQZ, kurse kemi edhe një pretendim të partive më të vogla parlamentare që secila ta ketë nga një përfaqësues?*

Baraliu: Kjo që secili subjekt politik parlamentar ta ketë nga një përfaqësues në KQZ, mendoj se nuk është as në përputhje me Kushtetutën e as me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ne kemi një vendim të kushtetueses, të cilin nuk po dua ta interpretoj tash, por atë dikush mund ta interpretojë si zgjerim të Kushtetutës. Ai është domosdoshmërisht i aplikueshëm. Nuk dua të jap ndonjë recetë se si të veprohet, sepse nuk më takon mua por, nëse subjektet politike kanë pretendime reale, atëherë ato do të duhej ta interpretojnë mirë vendimin e kushtetueses, sepse ai vendim është zgjatim i Kushtetutës dhe nenit përkatës. Prandaj, do të duhej që në mënyrë racionale dhe me mirëkuptim racional juridik ta analizojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe ta pranojnë zgjidhjen e cila është e domosdoshme për t'u aplikuar.

"Epoka e re": Në seancë disa subjekte politike kanë shprehur shqetësimin e tyre se pa funksionalizim të KQZ-së nuk mund të shkojë vendi në zgjedhje. Nëse mund të ketë ndonjë mocion të suksesshëm mosbesimi ndaj Qeverisë, a mund të organizohen zgjedhjet e parakohshme?

Baraliu: Nuk mund të ketë zgjedhje të reja pa funksionalizim të KQZ-së. Ne tani kemi një paralizë institucionale jo vetëm nga aspekti i zhvillimit të zgjedhjeve, që është kryesorja, sepse KQZ-ja është burim i demokracisë dhe burim i institucioneve të vendit. Kështu që, pa të dhe pa procedurat që zbaton ky institucion për zgjedhjet nuk mund të kemi zgjedhje. Pra, nuk mund të ketë zgjedhje të reja dhe me këtë jemi në një lloj paralize institucionale. Prandaj, po e shpreh shqetësimin tim se nuk është dashur të zvarritet kaq gjatë kjo çështje. Pastaj kemi edhe Kuvendin e Kosovës i cili, pa u funksionalizuar KQZ-ja, nuk mund ta bëjë zëvendësimin e mandateve të deputetëve. Siç dihet, PDK-ja tani ka një deputet më pak që i reflektohet këtij subjekti në fuqinë e tij politike në Kuvend. Pastaj në asambletë komunale ka shumë asamblistë të cilët nuk kanë mundur të zëvendësohen me të tjerët, gjë që reflektohet në efikasitetin e këtyre organeve. Për të gjitha këto fakte relevante do të duhej që urgjentisht subjektet politike të ulen në një tryezë politike dhe ta diskutojnë këtë çështje për të ardhur deri te zgjidhja.

Tahiri: Ndërgjegjësimi për dhunën në familje solli dënimin e parë kapital për këtë krim

EPOKA E RE — Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 MARS - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka nënshkruar të enjten memorandumin e bashkëpunimit me Zyrën e UnWomen në Kosovë, për Sistemin e Integruar për Evidentimin e Rasteve të Dhunës në Familje. Në ceremoninë e nënshkrimit, ministri Tahiri ka përmendur se pikërisht për dhunën në familje, për herë të parë gjykatat në Kosovë kanë shqiptuar dënimin kapital të burgimit të përjetshëm. Sipas ministrit Tahiri, ky fenomen duhet të trajtohet në tri fusha, atë të drejtësisë penale, të pozitës juridike të gruas si dhe në rrafshin e mbështetjes sociale. "Në fushën e drejtësisë penale, ndër kapitujt e veçantë të punës sime si Ministër i Drejtësisë ka qenë hartimi i Kodit të ri Penal i cili do të hyjë në fuqi muajin e ardhshëm dhe i cili për herë të parë ka sanksionuar si vepër penale dhunën në familje. Janë paraparë vepra penale që lidhen me cenimin e integritetit në marrëdhëniet familjare dhe është siguruar mbrojtje juridike për çdo viktimë të kësaj dhune. Pra, me Kodin e ri Penal kemi dhënë mesazh të prerë se abuzimi në familje, i çfarëdo forme, nuk do të tolerohet dhe do të ndëshkohet pa asnjë amnisti, siç e ka paraparë ligji", ka thënë ministri Tahiri.

Por që dhuna në familje të parandalohet, ministri Tahiri ka përmendur rëndësinë e përmirësimit të rolit të gruas në shoqëri. Sipas tij, pikërisht për këtë arsye ligjet e sponsoruara në Kuvend që tashmë janë në fuqi, siç është ai për Noterinë, Trashëgiminë, Procedurën Jokontestimore, i japin një shtyrje të fuqishme pozicionimit të gruas në kuptim të trashëgimisë, duke e bërë atë subjekt të patjetërsueshëm të trashëgimisë.

Ministri Tahiri ka shprehur konsideratë të lartë për zëvendësministrin e Drejtësisë, Naim Qelaj, i cili është edhe Koordinator Kundër Dhunës në Familje dhe, po ashtu, për UN Women, për punën e bërë për ngritjen e vetëdijesimit kundër dhunës në familje. "Databaza e dhunës në familje nuk ka qëllim klasik grumbullimin e të dhënave sa për t'i evidentuar ato, por edhe analizën shkak-pasojë në mes tyre, analizën e rasteve të dhunës ne familje, rrjedhimisht ndërtimin e një perspektive më efektive që iu përgjigjet problemeve reale", ka thënë ministri Tahiri.

Nënshkrues të këtij memorandumi janë edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skender Çoçaj, kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj.

Mjekë kardiokirurgë nga Italia po operojnë pacientët në QKUK

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 14 mars - Një ekip i mjekëve nga Italia, i udhëhequr nga dr. Carlo Barzaghi dhe dr. Maurizio Levantino, nga Spitali i Toskanas në Itali, po operojnë pacientë në QKUK. Mjekët italianë deri më tani kanë operuar katër pacientë me probleme kardiokirurgjike dhe gjatë gjithë kohës po asistohen edhe nga mjekët kardiokirurgë nga Kosova.

Gjatë vizitës që bëri në Shërbimin e Kardiokirurgjisë, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar, dr. Basri Sejdiu, ka thënë se ky bashkëpunim me mjekët italianë po bëhet në kuadër të ngritjes profesionale të stafit dhe është një ndihmesë e madhe për institucionin, kur kardiokirurgë ndërkombëtarë operojnë në Qendrën Klinike Universitare.

Drejtori Sejdiu ka lavdëruar edhe kardiokirurgët e QKUK-së, të cilët, sipas tij, janë duke e kryer punën mjaft mirë, përderisa ky bashkëpunim me mjekët e huaj bën që të kryhen edhe operacionet më të komplikuara. Dr. Maurizio Levantino, nga ekipi i mjekëve italianë, ka thënë se në Kosovë kanë ardhur me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe regjionit të Toskanës.

Dr. Levantino ka treguar se deri tani kanë kryer katër operacione të hapura në zemër, në bashkëpunim edhe me ekipin e mjekëve kardiokirurgë nga Kosova. Sipas tij, Kosova ka mjekë të mirë që kanë dëshmuar profesionalizmin edhe gjatë punës në operacione. Më 17 mars pritet që një ekip tjetër i mjekëve nga Italia të vijë në Kosovë për t'i operuar fëmijët që kanë probleme me zemër.

Ministri Gashi kërkon më shumë linja ajrore për bashkatdhetarët

Prishtinë, 14 mars - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur të enjten në takim drejtorin e operacioneve të Aeroports de Lyon që ka në menaxhim Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës " Adem Jashari", Jamel Ladhari, me të cilin ka diskutuar për hapjen e linjave të reja ajrore për bashkatdhetarët tanë që do t'i minimizonin kostot e biletave për të cilat diaspora e Kosovës tashmë disa vjet ankohet se janë të larta.

Gjatë këtij takimi ministri Gashi ofroi bashkëpunimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës që së bashku me menaxhmentin e Aeroportit, me tour operatorët nga Kosova dhe me agjencitë e tjera relevante, të ofrojnë kushte sa më të mira për udhëtimin e bashkatdhetarëve për në Kosovë. "Së shpejti do të bëhet një memorandum mirëkuptimi i cili do t'i theksojë qartë përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira. Koncentrimi ynë është që fillimisht të ulen çmimet e biletave duke futur konkurrencë sa më të madhe të avio-kompanive në Kosovë, e më pas edhe të parandalohet vjedhja nga tour operatorë mashtrues të cilët kanë dëmtuar në shumë raste bashkatdhetarët tanë", ka thënë Gashi, duke shtuar se në këtë kontekst do të formohet së shpejti një grup punues ku do të përfshihen ministritë e linjës si dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Ndërsa Ladhari ka theksuar se është duke punuar që të sjellë linja ajrore nga kompani me renome si Air France, KLM, SAS, British Airways në mënyrë që qarkullimi i pasagjerëve të jetë sa më i madh, ndërsa kostot të jenë më të ulëta.

UP-ja dhe ARC-ja nënshkruajnë memorandum për shkëmbim të të dhënave

Prishtinë, 14 mars (ER) - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka nënshkruar të enjten memorandum bashkëpunimi me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për shkëmbim të të dhënave ndërmjet këtyre dy institucioneve. Me anë të këtij memorandumi, parashihet shkëmbimi dhe identifikimi i saktë i të dhënave përkatëse, e cila i lehtëson proceset e punës së këtyre institucioneve.

Rektori i UP-së, Marjan Dema, u shpreh i lumtur për arritjen e këtij bashkëpunimi, i cili, sipas tij, do t'i shërbejë lehtësimit të proceseve të punës me studentë dhe staf në UP. "Ne jemi shumë të interesuar që qasja e studentëve në shërbimet e UP-së të lehtësohet, sidomos në aspektin teknologjik. Ky memorandum i nënshkruar sot shënon një hap tutje për realizimin e këtij objektivi", ka thënë rektori Dema.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i ARC-së, Bekim Hoxha, e ka konsideruar marrëveshjen me UP-në si njërën ndër marrëveshjet më të rëndësishme që ai ka nënshkruar, për faktin se ky memorandum do t'u shërbejë studentëve dhe personelit të universitetit më të madh në vend.

Nënshkrimin e këtij memorandumi e konsideroi të rëndësishëm edhe drejtori i Teknologjisë Informative në UP, Fatos Halilaj.

Ky memorandum bashkëpunimi do të fillojë zbatimin që nga dita e nënshkrimit.

Roli i Kryqit të Kuq të Kosovës, vlerë universale

Prishtinë, 14 mars (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Kosovës, të kryesuar nga kryetarja Feride Hyseni. Fillimisht, kryeministri Haradinaj është njoftuar nga Feride Hyseni për punët, sfidat dhe sukseset e Kryqit të Kuq të Kosovës, duke thënë se qëllimi kryesor është puna humanitare dhe ofrimi i shërbimeve kualitative humanitare për qytetarët. Kryeministri Haradinaj i ka përgëzuar përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Kosovës për misionin human që kanë, duke thënë se do ta kenë mbështetjen institucionale për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare.

Më tej, kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar dhe përcjellë nga afër aktivitetet e këtij institucioni, duke thënë se roli i tij humanitar dhe vullnetarizmi janë vlera universale dhe duhen mbështetur.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka theksuar se Qeveria e Kosovës është duke përmirësuar legjislacionin dhe i inkurajon ata në punën dhe misionin e tyre human në shërbim të qytetarëve dhe do të ofrojë bashkëpunim për aktivitetet humanitare të të gjitha organizatave.



Apostolova thotë se taksa po pengon agjendën e reformave evropiane të Kosovës

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalyia Apostolova, ka thënë të enjten se publikimi i Agjendës për Reforma Evropiane, ERA 2, po pengohet për shkak të vendosjes së taksës 100 për qind nga ana e Qeverisë së Kosovës për produktet e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. "Ne jemi në fillimin e lansimit të ERA 2 dhe mendoj se do të bëjmë një ceremoni kur kushtet politike të jenë të favorshme. Po flas për tarifat e vendosura të cilat po na pengojnë për vazhdimin e procedurave", ka deklaruar Apostolova

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 14 mars - Instituti i Prishtinës për Studime Politike ka organizuar të enjten tryezë rreth zbatimit të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) dhe pritshmëritë e ERA 2. Në këtë tryezë ka marrë pjesë edhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalyia Apostolova, e cila ka pohuar se publikimi i Agjendës për Reforma Evropiane, ERA 2, po pengohet për shkak të kushteve politike dhe vendosjes së taksës 100 për qind nga ana e Qeverisë së Kosovës për produktet e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. "Ne jemi në fillimin e lansimit të ERA 2 dhe mendoj se do të bëjmë një ceremoni kur kushtet politike të jenë të favorshme. Po flas për tarifat e vendosura të cilat po na pengojnë për vazhdimin e procedurave", ka deklaruar Apostolova.

E pranishme në këtë tryezë ishte edhe ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, e cila nuk foli për konstatimet e zyrtares evropiane, Apostolova, për tarifën dhe pengesën që ajo po i bën procesit të integrimit. Ministrja Hoxha ka theksuar se zbatimi i ERA-s është dokument i përbashkët i Kosovës dhe BE-së. Ajo ka thënë se ky dokument ka filluar së zbatuari më 11 nëntor 2016, në takimin e parë të dialogut të nivelit të lartë BE - Kosovë. "Po qe se shohim nivelin e zbatimit të ERA-s që nga nëntori 2016 e deri në fund të janarit 2019 janë zbatuar plotësisht 11 nga 22 prioritete, ose 50 për qind e tyre. Gjysma e tyre janë në zbatim e sipër", ka thënë Hoxha, duke shtuar se plani i veprimit është zbatuar 71.11 për qind, pasi që 96 nga 135 veprimet janë zbatuar plotësisht. Ajo ka bërë me dije se në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e BE-së janë duke punuar në draftin final të ERA 2 dhe, sipas saj, shumë shpejt do të miratohet në Qeveri për t'u përcjellë pastaj në Kuvend. "Presim që gjatë vitit 2019 ta rrisim dinamikën e zbatimit të prioriteteve të ERA 2 dhe do të përpiqemi t'i tejkalojmë planet", ka thënë ministrja Hoxha.

Në këtë tryezë mori pjesë ambasadorja e Holandës, Gerrie Willems, Leonora Kryeziu, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën doganore 100 për qind ndaj produkteve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina është në fuqi që nga 21 nëntori i vitit të kaluar. Bashkimi Evropian po kërkon në vazhdimësi nga ana e Kosovës ta heqë tarifën pasi ajo, sipas zyrtarëve të BE-së, është në kundërshtim me marrëveshjen e tregtisë së lirë në mes të vendeve të rajonit si dhe po pengon vazhdimin e bisedimeve të ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Edhe Shtetet e Bashkuara i kanë bërë thirrje Kosovës që ta heqë këtë masë, duke thënë se ajo nuk përkon me interesat amerikane. Por, Qeveria e Kosovës, të paktën deri më tani, nuk është zmbrapsur nga vendimi për tarifën 100 për qind, i cili vazhdon të mbetet në fuqi.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se taksa do të hiqet vetëm kur Serbia ta njohë Kosovën.

Zëvendësministrja Vuniqi kërkon mbështetjen e Bavarisë për liberalizimin e vizave

Prishtinë, 14 mars (ER) - Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, Rejhan Vuniqi, ka filluar një vizitë zyrtare dyditore në Bavari, ku fillimisht është pritur në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Bavarisë nga sekretari i Shtetit, Gerhard Eck. Temë kryesore e këtij takimi, që është ngritur nga zëvendësministrja Vuniqi, ishte çështja e liberalizimit të vizave.

Në fillim të takimit zëvendësministrja Vuniqi e ka falënderuar shtetin dhe popullin gjerman për të gjithë mbështetjen që i kanë ofruar dhe vazhdojnë t'i ofrojnë Kosovës. Më pas, ajo ka folur për rëndësinë e heqjes së vizave për shtetasit e Kosovës, duke kërkuar që edhe në këtë proces Gjermania t'i qëndrojë afër Kosovës, siç e ka dëshmuar gjatë gjithë rrugëtimit të kosovarëve drejt paqes dhe shtetndërtimit.

Më tutje, ajo ka ritheksuar se ky proces varet prej qëndrimeve të shteteve anëtare, megjithatë mbështetja e shtetit gjerman është shumë e rëndësishme dhe thelbësore në këtë proces. "Kosova nuk mund të mbetet edhe më tutje shteti i vetëm i izoluar në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Vuniqi.

Përfaqësuesit e palës gjermane në këtë takim kanë premtuar se Kosova do ta ketë mbështetjen e parezervë në procesin e liberalizimit, edhe pse e tëra nuk varet nga landi i tyre. Gjatë takimit është diskutuar edhe mbi rolin, kontributin dhe integrimin e shtetasve kosovarë në shoqërinë dhe institucionet gjermane, për shqyrtimin e mundësisë për lehtësimin e procedurave të shtetësisë dhe për thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit me institucionet e Kosovës.

Në fund të takimit, zëvendësministrja Vuniqi e ka ftuar sekretarin Eck për vizitë në Kosovë, për t'u njohur nga afër me realitetin dhe përparimet që janë bërë falë ndihmës gjermane.

Mbështetja e BE-së për MTI-në, shumë e nevojshme

A. MAVRAJ

Prishtinë, 14 mars - Në takimin e dytë të Komitetit Drejtues të Projektit "Mbështetje e Mëtutjeshme e Zhvillimit të Tregtisë në Kosovë", i financuar nga BE-ja, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka theksuar se objektivi i përgjithshëm i projektit është vazhdimi dhe promovimi i integrimit të Kosovës në ekonominë botërore dhe përforcimi i rolit të shtetit në qeverisjen ekonomike.

Ministri Shala ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë hapin e parë për negocimin e marrëveshjes tregtare EFTA, ku në muajin nëntor të vitit të kaluar është nënshkruar Deklarata e Përbashkët për Bashkëpunim dhe, po ashtu, në muajin qershor 2018 është marrë vendimi për aplikim në OBT në statusin e anëtarit vëzhgues. "Aktivitet me prioritet për MTI-në është hartimi i Ligjit për Tregti të Brendshme dhe Ligji për Tregti me Jashtë, prandaj falënderoj projektin për përkrahjen dhe ekspertizën që po ndihmon në këtë drejtim. Gjithashtu, presim përkrahje gjatë zhvillimit të negociatave me vendet e EFTA-s dhe në rrugën tonë drejt anëtarësimit në OBT", ka thënë ministri Shala.

Shala ka potencuar se ky projekt ka një agjendë ambicioze, duke shtuar se në fund do të ndahen të gjithë të kënaqur. "Pasi që do të bëjmë punë të mëdha e që do të rezultojnë me përmirësimin e kapaciteteve të MTI-së për të zhvilluar negociata dhe zbatuar politikat tregtare, përfshirë mbrojtjen dhe zbatimin e pronësisë intelektuale, në përputhje me kërkesat e tregtisë ndërkombëtare dhe praktikat e BE-së dhe për përmirësimin e kapacitetit të saj për t'i mbështetur prodhuesit vendorë", është shprehur ministri Shala.

Ai ka theksuar se do të ishin mirënjohës nëse mandati i projektit do të zgjatej përtej muajit korrik 2020. "Departamenti i Tregtisë dhe aktorët e tjerë relevantë kanë nevojë për ekspertizën e ekspertëve nga BE-ja dhe për praktikat më të mira ndërkombëtare. Për këto dhe aktivitete të tjera në kuadër të projektit keni përkrahjen time të parezervë dhe besoj se e njëjta do të jetë edhe nga ana e projektit dhe Zyrës së BE-së ndaj MTI-së", ka thënë Shala.

Haradinaj: Sektori privat, promotor i zhvillimit ekonomik

Prishtinë, 14 mars (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim disa prodhues vendorë, me të cilët ka biseduar për punët, sfidat dhe aktivitetet e tyre ekonomike.

Gjatë takimit, në të cilin ishin të pranishëm edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, kryetari i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, si dhe përfaqësuesi i ZRRE, kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës është duke punuar me të gjithë dhe me përkushtim për përmirësimin e legjislacionit i cili do të krijojë mundësi më të mëdha për sektorin privat.

Ndër temat kryesore të takimit ishte furnizimi i rregullt i operatorëve prodhues me energji dhe çmimi i saj. "Çmimi dhe furnizimi i rregullt me energji është çështje e rregullatorit për energji por, në bazë të kompetencave, do ta shoh mundësinë e gjetjes së një zgjidhje të kënaqshme për prodhuesit vendorë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar se sektori privat është promotor i zhvillimit ekonomik të vendit.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e bizneseve kërkuan mbështetjen e qeverisë për ofrimin e kushteve më të mira për zhvillimin e afarizmit të tyre, përfshirë politikat më të guximshme në sektorin e tregut energjetik. Vizitat në biznese dhe takimet me përfaqësuesit e bizneseve, kryeministri Haradinaj është duke i zhvilluar në kuadër të vitit ekonomik.

Telekomi i Kosovës nënshkruan kontrata bashkëpunimi edhe me dy biznese vendore

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Telekomi i Kosovës ka nënshkruar sot kontrata bashkëpunimi me dy biznese vendore, "Monting SHPK" dhe "American Clinic".

Drejtor i Shitjes në Telekomin e Kosovës, Demir Lima, ka shprehur vullnetin e tij dhe të menaxhmentit për një kompani të orientuar tërësisht drejt konsumatorit. "Është jashtëzakonisht e rëndësishme që t'i rikthejmë dhe t'i shtojmë konsumatorët e rinj në familjen tonë të madhe. Ky rikthim i besimit në Telekomin e Kosovës dëshmon se ne vazhdojmë të jemi lider i pamohueshëm për ofrimin e shërbimeve për të gjithë konsumatorët tanë", ka pohuar Lima.

Ndërsa bizneset e rikthyera sot në Telekomin e Kosovës kanë shprehur besimin e plotë në telekom. Drilon Brahimi nga kompania vendore "Monting SHPK" ka shprehur besimin se kontrata e nënshkruar është vetëm fillimi i një bashkëpunimi edhe më të madh me Telekomin e Kosovës që vjen si rezultat i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga kjo korporatë. Një tjetër biznes i rëndësishëm në fushën e vet, "American Clinic", gjithashtu ia ka besuar tërë komunikimin Telekomit të Kosovës. Drejtori i kësaj klinike, Armend Vokshi, ka theksuar se kujdesi dhe shërbimet e Telekomit e kanë bindur që t'i bashkohet korporatës.

Veseli fton investitorët nga Japonia të investojnë në Kosovë

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 MARS - Në vazhdim të vizitës së tij në Tokio, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është pritur në takim nga Hiroshigo Seko, ministër për Ekonomi, Tregti dhe Industri në Qeverinë japoneze. Në fjalën e tij, kryetari Veseli ka bërë një ekspoze të mundësive që ofron Kosova në fushën e investimeve të jashtme, duke potencuar faktin e lehtësirave fiskale për bizneset e reja si dhe fuqinë e re punëtore. Ai ka kërkuar nga ministri Seko që bizneset japoneze të vijnë në Kosovë për t'i hulumtuar mundësitë për investime.

Nga ana e tij, ministri japonez i Ekonomisë ka thënë se Japonia është e interesuar që bizneset e saj, sidomos markat e njohura të industrisë japoneze, të jenë sa më shumë të pranishme në Evropë dhe Kosova përbën një fushë të interesimit. Ai ka theksuar se tash që do ta fillojë punën Ambasada e Japonisë në Prishtinë, mundësitë e komunikimit dhe të bashkëpunimit do të jenë shumë herë më të mëdha.

Veseli ka përmendur sektorin e teknologjisë së informacionit, si një sektor në të cilin ekziston një potencial i madh bashkëpunimi midis dy vendeve. Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan që në të ardhmen e afërt të ndodhin vizita reciproke të delegacioneve nga fusha e bizneseve, në mënyrë që bashkëpunimi të fillojë me hapa konkretë. Po ashtu, Veseli ka zhvilluar takim edhe me kryetarin e Komitetit për Punë të Jashtme në Parlamentin japonez, Wakamiya Kenji.

Në takim u bisedua për marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Japonisë, me theks të veçantë zgjerimin e tyre. Gjithashtu, kryeparlamentari Veseli ka bërë një ekspoze të përgjithshme të raporteve ndërkombëtare të Kosovës dhe vizionin që ndjek Kosova në raport me rajonin dhe integrimet euroatlantike. Ndërkaq Kenji ka potencuar qëndrimin konsistent të shtetit japonez në mbështetje të synimeve ndërkombëtare të Kosovës.

Veseli ka folur për procesin e integrimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe me këtë rast ka kërkuar që Japonia ta mbështesë këtë proces. Kenji ka pohuar se prania e Kosovës në këto organizata është në dobi të të gjithëve. "Ne ju kemi njohur ndër të parët, duam të kemi marrëdhënie praktike mes dy vendeve tona dhe është në duart tona që kjo të ndodhë", ka deklaruar Kenji.

Deputetët vizitojnë AKK-në, temë diskutimi parandalimi i korrupsionit

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë vizituar Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK).

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Takimi është fokusuar në aktivitetet e ndërmarra nga Agjencia Kundër Korrupsionit për zbatimin e këtij ligji, për sfidat me të cilat po përballen institucionet, autoritetet përgjegjëse, për zbatimin sa më të duhur të ligjit, si dhe për aktet nënligjore të cilat obligojnë autoritetet përgjegjëse të miratojnë siç përcakton ky ligj.

Komuna e Prishtinës bën thirrje për ruajtjen e hapësirave publike

Prishtinë, 14 mars (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se parkimi pavend i veturave dhe dëmtimi i gjelbërimit është i ndaluar dhe dënohet me gjobë mandatore. Në këtë drejtim Komuna e Prishtinës u ka bërë thirrje qytetarëve që të kujdesen për ruajtjen e mjedisit. "Respektimi i rregullave kushton më lirë. Parkimi pa vend dhe dëmtimi i gjelbërimit është i ndaluar dhe dënohet me gjobë mandatore. Mbi të gjitha, nuk është sjellje e mire qytetare. Të kujdesemi për mjedisin ku jetojmë dhe të bëhemi shembull i mirë për brezat e rinj!", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Gjilani merr mbështetje prej 1.7 milion eurosh nga Ministria e Infrastrukturës për projekte lokale

Gjilan, 14 mars (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Gjilanit, Lutfi Haziri, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, në mbështetje të projekteve lokale të kësaj komune.

Komuna e Gjilanit për vitin 2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit përfiton mbështetje financiare në vlerë prej 1 700 000 eurosh për realizimin e disa projekteve të reja infrastrukturore lokale. Ministri Lekaj ka kërkuar nga i pari i Gjilanit implementim cilësor të projekteve dhe respektim të afateve kohore për zbatim të tyre.

Lekaj e ka siguruar kryetarin Haziri se mbështetja e vazhdueshme e MIT-së për komunat nuk do të mungojë. Gjatë këtij takimi ministri Lekaj kumtoi edhe lajmin se zgjerimet e hyrjeve në drejtim të Gjilanit nga Prishtina dhe Kllokoti do të fillojnë në muajin qershor. Këto dy investime, që secila kanë kosto rreth katër milionë euro, realizohen me kredinë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Lekaj dhe Haziri diskutuan edhe për zhvillimin e punimeve në autostradën e Gjilanit, duke ritheksuar edhe rëndësinë e këtij investimi në lidhjen e korridoreve evropiane.

I pari i Gjilanit, duke e falënderuar ministrin Pal Lekaj, ka thënë se kjo ndihmë e nivelit qendror, konkretisht nga MIT-ja për projektet lokale, është dëshmi se të dyja nivelet kanë bashkëpunim të mirë dhe i kontribuojnë mirëqenies së qytetarëve pa dallim bindjesh politike.

Financohet ndërtimi i rrugës Miradi e Epërme - Zona Industriale në Fushë-Kosovë

Fushë-Kosovë, 14 mars (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit (MTI), Pal Lekaj, pas një takimi me kryetarin e Fushë-Kosovës, Burim Berisha, ka nënshkruar të enjten një marrëveshje bashkëpunimi me këtë komunë, për mbështetje financiare për rikonstruimin e rrugës Miradi e Epërme - Zona Industriale.

Për këtë vit kjo ministri ka ndarë 130 000 euro për realizimin e këtij projekti, kurse për dy vjetët e ardhshëm për këtë projekt janë planifikuar edhe 400 000 euro të tjera në mënyrë që projekti të përmbyllet në tërësi.

Lekaj e Berisha kanë biseduar edhe për disa projekte të përbashkëta që mund të realizohen me bashkëpunim në mes të komunës dhe ministrisë.

Ministri Lekaj, duke i ofruar mbështetjen e parezervë kryetarit Berisha, ka thënë se edhe kjo komunë, sikurse të gjitha të tjerat, do ta ketë përkrahjen e dikasterit që ai drejton për realizimin e projekteve lokale në mënyrë që t'i shërbehet interesit të qytetarëve dhe që ata t'i përfitojnë përfitimet e taksave të tyre si kthim nga qeverisjet lokale dhe qendrore.

Ndërsa kryetari Berisha e ka falënderuar ministrin Lekaj për këtë mbështetje, duke shtuar se iniciativa për mbështetje të projekteve lokale nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit është veprimi më i duhur dhe më i qëlluar që shkon në shërbim të qytetarëve.

Bizneset në Suharekë obligohen ta pastrojnë hapësirën para lokaleve të veta

Suharekë, 14 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka marrë vendim që secili biznes apo institucion ta pastrojë çdo ditë hapësirën para lokalit të vet. Muharremaj ka bërë me dije se për zbatimin e këtij vendimi ka obliguar Drejtorinë e Inspeksionit dhe policinë. "Secili biznes/institucion tash e tutje obligohet që hapësirën para lokalit apo objektit ta pastrojë çdo ditë me qëllim të mirëmbajtjes së ambientit. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria e Inspeksionit dhe Policia, të cilat kujdesen sipas ligjeve në fuqi për zbatimin e urdhëresës. Gradualisht ne do të kemi hapa konkretë për ruajtjen e ambientit, i cili është i të gjithëve", ka thënë Muharremaj.

Opozita e Kosovës, veç 'një tigër prej letre'

Fadil MALOKU

1. Opozita (LDK-ja dhe LV-ja, por jo edhe fraksioni i saj tash, PSD-ja, që është bërë pjesë e qeverisë) me indiferencën, neglizhencën, sidomos me agresivitetin e heshtur, në temat e karakterit nacional dhe shtetëror, lëre që e ka degraduar e shëmtuar diskursin dhe kultin mbi demokracinë e pluralizmin politik, por edhe e ka vonuar (për të mos thënë bastarduar) nevojën e ndryshimit të "etheve" të tranzicionit nëpër të cilën po kalon Kosova në këto dy dekada koti.

2. Opozita me (argatët e djajve qeveritarë të pasluftës) qëndrimin jokoherent në publik, me akuzat dhe kundërakuzat improvizuese e joatraktive për temat, shqetësimet dhe mundimet jorelevante nëpër të cilat po i kalon vendi, jo vetëm se nuk po demonstron fuqi dhe karizmë të numrave (se e ka shumicën shqiptare pas vetes), pr, nuk po dëshmon as fuqi e as sens e interesim për ta ndryshuar gjendjen shpërthyese, ekonomike dhe sociopolitike.

3. Duket që ajo këtë po e bën qëllimisht dhe për disa arsye; a) ka vlerësuar (pa matje të duhura në publikun e gjerë) që temat si demarkacioni, gjykata, e sidomos tema e "korrigjimit" (lexo copëtimit) është ajo "patatja e nxehtë" të cilën mund ta kryejnë vetëm aktorët (alias komandantët) e luftës; b) ka nuhatur qartë gabimisht, se temat dhe problemet nacionale së bashku me ato shtetërore i takojnë ekskluzivisht qeverisë; c) ka nënvlerësuar dhe nënçmuar "peshën e vet specifike" në raport me pakicën aktuale qeveritare; d) ka demonstruar deri më tani vetëm "fuqi tigri prej letre", sidomos kur janë në pyetje krimi, korrupsioni, papunësia dhe varfëria marramendëse; e) ka kultivuar e ndërtuar atmosferë fatpajtuese dhe koketuese me qeverinë (fraksioni i LV-së) në vend të një "agresiviteti" evident demokratik, në parlament, në medie e, pse jo, edhe në rrugë; e) ka kalkuluar (duke mos u ofruar alternativa) me kurtuazi shëmtuese, me aleatë dhe miqtë ndërkombëtarë; f) ka injoruar trendët e pakënaqësisë sociale dhe ato ekonomike të vendit; g) ka margjinalizuar rolin dhe rëndësinë e shoqërisë civile dhe të medieve neutrale.

Këtë muaj në Tiranë do të nënshkruhet kalendari i përbashkët Kosovë - Shqipëri

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të enjten në takim ministren e Kulturës së Shqipërisë, Elva Margariti. Ata kanë bashkëbiseduar për tema të rëndësishme në fushën e kulturës, me theks të veçantë për nënshkrimin e kalendarit të përbashkët kulturor në mes të Kosovës dhe Shqipërisë për vitin 2019, i cili do të nënshkruhet gjatë këtij muaji në Tiranë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prizren, 14 mars - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të enjten në takim ministren e Kulturës së Shqipërisë, Elva Margariti, bashkë me një delegacion nga kjo ministri. Ministri Gashi u shpreh i kënaqur me realizimin e këtij takimi me ministren Margariti, siç tha ai, në kryeqytetin historik të kulturës dhe të trashëgimisë, në Prizren. "Bashkëbiseduam për tema të rëndësishme në fushën e kulturës, me theks të veçantë për nënshkrimin e kalendarit të përbashkët kulturor në mes të Kosovës dhe Shqipërisë për vitin 2019, për të cilin u pajtuam që të nënshkruhet gjatë këtij muaji në Tiranë. Do të jetë një kalendar dinamik me aktivitete të përbashkëta të institucioneve kulturore edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri", ka thënë ministri Gashi. Ai ka theksuar se ky bashkëpunim do të jetë i fuqishëm dhe i përkushtuar nga të dyja palët.

Ministri Gashi, po ashtu, ka njoftuar se gjatë takimit u diskutua edhe për një kalendar të përbashkët mes tri shteteve: Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. "Dëshirojmë të kemi një kalendar trepalësh në mënyrë që aktivitetet tona të shtrihen edhe në Maqedoni, edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri", është shprehur Gashi, duke e konsideruar të rëndësishme që në krye të Ministrisë së Kulturës maqedonase është një shqiptar.

Po ashtu, ministri Gashi ka theksuar se në takim u diskutua edhe për mundësinë e krijimit të një fondi të përbashkët kulturor. "Edhe Kosova, edhe Shqipëria ta kenë një fond të përbashkët, ku institucionet e kulturës të kenë mjete të mjaftueshme për realizimin e projekteve. Dhe, ky fond, të jenë në vazhdimësi në shërbim të komunitetit artistik", është shprehur ministri Gashi, duke uruar që ky bashkëpunim të jetë afatgjatë.

Ndërkaq ministrja Margariti fillimisht ka theksuar se ky bashkëpunim është vazhdim i një pune të filluar më përpara. "Ky është vetëm një institucionalizim, një marrëveshje që krijon një kornizë formale, por përtej kësaj gjithmonë kemi mbështetur të gjithë aktivitetet dhe artistët në të dy shtetet. Jam entuziaste të marrim hapa të rinj që të çojmë përpara projekte të reja siç është ajo e një kalendari edhe më të shtrirë, duke pasur dhe përvojën tashmë të kalendarëve të viteve të mëparshme, të vazhdojmë të kemi të tjera edhe me shtetet fqinjë", ka thënë ministrja Margariti, duke e përmendur shumë të rëndësishëm edhe krijimin e një fondi të përbashkët. Ministrja Margariti, po ashtu, u shpreh e kënaqur që u prit në qytetin e Prizrenit.

Scaparrotti: Rusia po financon parti në Ballkan kundër BE-së dhe NATO-s

Uashington, 14 mars - Komandanti i trupave amerikane për Evropën, gjenerali Curtis Scaparrotti, e ka akuzuar Moskën se po financon parti politike në Ballkan për ta penguar integrimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian dhe NATO. "Ata bëjnë përpjekje për të minuar çdo përparim drejt integrimeve euroatlantike, BE, NATO etj. Këtë e bëjnë kryesisht përmes dezinformimit, e bëjnë duke financuar dhe mbështetur parti radikale. Ata jodomosdoshmërisht përcaktojnë se cilin krah mbajnë. Rëndësi ka që ta minojnë qeverinë aktuale në çdo hap të hedhur përpara. Shohim që ky aktivitet është shtuar gjatë 6 apo 8 muajve të fundit në Ballkan", ka deklaruar Scaparrotti.

Gjatë një raportimi përpara anëtarëve të Komisionit të Shërbimeve Ushtarake të Dhomës së Ulët të Kongresit Amerikan, gjenerali Scaparrotti ka paralajmëruar se rusët mund të organizojnë akte dhune në Maqedoninë e Veriut para anëtarësimit të plotë në NATO.

"Hyrja e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në NATO besoj se janë të papranueshme për Rusinë. Besoj se ata vazhdimisht do të përpiqen të ndërhyjnë në Maqedoninë e Veriut siç bënë me Malin e Zi", ka thënë ai.

Moska e ka shprehur hapur qëndrimin kundër anëtarësimit në NATO të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, pavarësisht se ka mohuar përfshirjen në tentativën për grusht shteti në Mal të Zi që u zbulua tetorin e vitit 2016. Disa ditë më parë,

edhe kreu i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ngriti shqetësimin se Rusia po përpiqet të ndërhyjë në zgjedhjet e disa vendeve evropiane, përfshirë këtu edhe rastin Brexit.

Joe Bideni pranë shpalljes së kandidaturës për president

> Nëse Joe Bideni kandidon, anketat tregojnë se ai do të ishte në krye të listës së demokratëve që kërkojnë presidencën, por do të ketë mjaft konkurrencë, përfshirë senatorin Bernie Sanders



Uashington, 14 mars - Ish-nënpresidenti amerikan, Joe Biden, duket se po i afrohet vendimit për të hyrë në garën presidenciale dhe një vendim zyrtar mund të shpallet brenda disa javësh. Nëse Biden kandidon, anketat tregojnë se ai do të ishte në krye të listës së demokratëve që kërkojnë presidencën. Por, është shumë e mundur që Biden të përballet me kritika lidhur me pikëpamjet e tij të moderuara nga rivalët demokratë, një pjesë e mirë e të cilëve anojnë më nga e majta e spektrit politik.

Anëtarë të Sindikatës së Zjarrfikësve e nxisin Biden të kandidojë për president. "E vlerësoj energjinë që treguat kur po vija në skenë. Ruajeni edhe pak. Mund të më duhet pas disa javësh", tha Bideni.

Në Uashington, Biden dha një ide të temave të fushatës nëse hyn në garë. "Njerëzit duhet të trajtohen me dinjitet dhe respekt. Duhet t'i japim gjithkujt një shans. Të mos injorojmë askënd, të mos demonizojmë askënd, as të varfrin, as të dëshpëruarin, as imigrantin, as tjetrin", tha ai.

Biden kryeson në anketa mes emrave demokratë që kanë kandiduar, por do të ketë mjaft konkurrencë, përfshirë senatorin Bernie Sanders. "Ato idetë radikale për të cilat folëm para katër vjetësh? Sot, praktikisht, të gjitha ato ide mbështeten nga shumica e amerikanëve", thotë senatori Sanders.

Mbi 12 demokratë kanë hyrë në garë, përfshirë disa që mund t'i tërheqin votuesit më të rinj dhe më të larmishëm, si senatorja nga Kalifornia, Kamala Harris. "Rregullat nuk po zbatohen njëlloj për të gjithë në vendin tonë. Jo të gjithë kanë qasje të barabartë në rrugën e suksesit", tha ajo në një nga ndalesat e fushatës.

Presidenti Donald Trump ka akuzuar demokratët se po anojnë nga socializmi, veçanërisht me propozimin ambicioz të mjedisit, të njohur si "Pakti i ri i gjelbër". "Dua që ta bëjnë temë fushate këtë plan. Dua të jem republikani që kandidon përballë tyre", tha ai.

Shumë demokratë do ta mirëprisnin hyrjen e Bidenit në garë, thotë analisti Jim Kessler. "Tregon që njerëzit e pëlqejnë. Ka shumë pak demokratë që nuk e pëlqejnë. Duan që ai të futet në garë", tha ai.

Por Bideni mund të ketë vështirësi për shkak të moshës 76-vjeçare dhe historisë së tij të politikave centriste, thotë John Hudak i Institutit Brookings. "Por edhe për shkak të historisë së tij legjislative si senator, lidhur me çështje si drejtësia penale që nuk përputhen shumë me vlerat e demokratëve të sotëm. Dhe kështu versioni i vitit 1994 i Joe Bidenit, mund të jetë kundërshtari më i ashpër i versionit të vitit 2020 të Joe Bidenit", tha Hudak.

Por argumenti më i fortë i Bidenit mund të jetë se ai do të ishte një rival i fortë ndaj presidentit Trump, thotë analisti Will Marshall. "Donald Trumpi mund të jetë një figurë polarizuese në shkallë kombëtare, por është bashkues për demokratët. Ata janë absolutisht të bashkuar në vendosmërinë që ai të mos zgjidhet më", tha Marshalli.

Bideni dështoi në dy gara të mëparshme presidenciale, por ai vazhdon të jetë popullor mes demokratëve, pasi shërbeu për tetë vjet si nënpresident gjatë mandatit të presidentit Barack Obama.

Parlamenti britanik kundër referendumit të ri për Brexit-in

Londër, 14 mars - Parlamenti britanik ka votuar kundër mbajtjes së një referendum të ri për Brexit-it. Ligjvënësit kundërshtuan mocionin me 334 vota kundër dhe 85 për.

Ky votim, nuk i pengon ligjvënësit, që në një periudhë të ardhshme, sërish të fitojnë mbështetjen e Parlamentit për një referendum të dytë të Brexit-it, raporton Asoshiated Press.

Parlamenti britanik po mban një sërë votimesh të enjten nëse do të shtyjë largimin e Britanisë nga blloku 28-vendesh, i cili aktualisht është planifikuar për në 29 mars.

Procesi i daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja ka hyrë në një periudhë të paqartësisë së madhe pasi Parlamenti britanik rrëzoi dy marrëveshje që parashihnin modalitetet e daljes së vendit nga BE-ja.

Marrëveshjet ishin arritur përmes negociatave të Qeverisë britanike të udhëhequr nga Theresa May dhe udhëheqësve të Bashkimit Evropian.

Ndërkohë të mërkurën, ligjvënësit britanikë kanë votuar kundër largimit nga Bashkimi Evropian pa një marrëveshje paraprake.

Me 321 vota për dhe 278 kundër ata i kanë bërë thirrje Qeverisë britanike që të përjashtojë mundësinë e një Brexit-i pa marrëveshje.

Zyrtarët e BE-së kanë thënë dhe përsëritur se do të kenë nevojë për një justifikim të mjaftueshëm në mënyrë që të pajtohen për shtyrjen e afatit përfundimtar për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E jashtëzakonshme

Fiton lotarinë 30 herë brenda një dite

Kjo grua pa dyshim është shumë me fat. Deborah Brown nga Richmond, Virginia fitoi 30 herë lotarinë brenda një dite. Ajo bleu 30 bileta me kombinimin e numrit fitues 1-0-3-1, ka raportuar "NBC News". Gruaja mori në shtëpi një shumë në total prej 150 mijë dollarësh. Fillimisht Brown bleu 20 bileta për 1 dollarë dhe më vonë shkoi të blinte edhe 10 të tjera. Për secilën biletë, ajo fitoi një çmim prej 5 000 dollarësh.

FOTO E DITES



Ish-nënpresidenti Joe Biden gjatë paraqitjes në konferencën ndërkombëtare të Shoqatës së Zjarrfikësve në Uashington, DC. /AFP/

E rrallë

Pulat bëhen bashkë e vrasin dhelprën

Pulat e një ferme në Francën veriperëndimore janë bërë bashkë dhe kanë mbytur një dhelpër. Incidenti i pazakontë në Brittany ndodhi pas dhelpra hyri në kotecin e 3000 pulave përmes një dere automatike që u mbyll menjëherë. Kreu i shkollës bujqësore Gros-Chene, Pascal Daniel, ka bërë me dije se për t'u mbrojtur shpendët sulmuan kafshën me sqepin e tyre.

BARSOLETA E DITËS

Një polic po rruhej te berberi.
- Berberi: Çka punoni?
- Polici: Jam polic. Po ju?

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D



I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Sot do të keni bashkëpunime të frytshme në fushën profesionale dhe mund të vijoni të mbështeteni tek të njëjtit persona.

DEMI
Nëse merreni kaq shumë kohë me punën nuk do të mund t'i dedikoni kohë jetës personale. Duhet t'i ndani prioritetet tuaja të çastit.

BINJAKËT
Edhe pse nuk keni marrë gjithçka që keni pretenduar, sot bëni mirë të lini pak kohë të kalojë përpara se të kërkoni shpjegime.

GAFORRJA
Keni pak vështirësi ta menaxhoni kohën për impenjimet tuaja sot. Nëse nuk ja arrini dot i vetëm, kërkoni ndihmë nga kolegët.

LUANI
Nuk është se ju kanë mbetur shumë gjëra për t'i vlerësuar kohët e fundit. Të gjitha situatat që mund t'i shfrytëzonit i keni mbaruar.

VIRGJËRESHA
Disa kritika konstruktive është mirë kur bëhen në kohë sepse mund t'i rikuperoni. E rëndësishme është të mos i keqinterpretoni.

PESHORJA
Keni hapur mundësi të reja bashkëpunimi me persona që i njihni mirë. Nuk jeni penduar aspak për shanset e reja që ju keni dhënë.

AKREPI
Edhe pse biseda me një mik të vjetër ju bën të mendoni qartë për situatat tuaja, sot nuk do të keni mundësi të konsumoni kohë me të.

SHIGJETARI
Dikush do të jetë pjesë e projekteve dhe planeve tuaja në të ardhmen. Nuk keni pse e ndaloni sepse mund t'ju japë shumë komoditet kjo gjë.

BRICJAPI
Sot nuk keni pse viheni në garë me të tjerët për t'i treguar aftësitë tuaja. Nëse jeni i bindur që dini t'i bëni mirë gjërat nuk ka pse tregoni dyshime.

UJORI
Nëse doni ta ngjyrosni ditën tuaj me sa më shumë humor atëherë duhet të bëni diçka si për ju dhe për personat që doni.

PESHQIT
Doni pak qetësi sot dhe nëse nuk mund ta shijoni ditën siç ëndërronit, të paktën bëni të mundur që të mos keni debate dhe keqkuptime.

Selena Gomez paralajmëron albumin e ri

Selena Gomezi ka folur për albumin e saj të ri. Gjatë një video "live" në rrjetin social "Instagram" kohën e fundit, këngëtarja 26-vjeçare foli rreth videoklipi të ri për këngën "I Can't Get Enough" me Benny Blanko, Tainy dhe J. Balvin dhe siguroi fansat se albumi i saj i ardhshëm do të jetë gati së shpejti. "Unë jam aktualisht në studio dhe po shkon shumë mirë", ka thënë Selena.

Nick Jonas i blen veturë gruas

Aktroja indiane Priyanka Chopra ka marrë një dhuratë të veçantë nga burri i saj, Nick Jonas. Jonas asaj i ka blerë një veturë "Mercedes" të tipit "Maybach". Kjo veturë kushton 199 900 dollarë amerikanë.

Dua Lipa shfaqet pranë të dashurit

Ata janë të njohur si një nga çiftet që nuk ndahen asnjëherë. Dua Lipa dhe i dashuri i saj, Isaac Carew, 32-vjeçar, dukeshin shumë të lumtur dhe të dashuruar në promovimin e librit të ri "The Dirty Dishes" të Isaac Carew në Londër. Këngëtarja e hitit "One Kiss", 23 vjeçe, dukej mahnitëse, e veshur me një fustan të zi dhe ari të ndezur, teksa vinte në pah këmbët atraktive, shkruan "DailyMail".

Luke Perry po planifikonte të martohej këtë verë

Luke Perry dhe e fejuara e tij Wendy Madison Bauer po planifikonin të martoheshin gjatë këtij viti, para vdekjes së tij që ndodhi në fillim të këtij muaji. "TMZ" raporton se çifti parashikoi një martesë gjatë verës në LA, më saktësisht më 17 gusht. Luke vdiq në spital disa ditë pasi pësoi një sulm në shtëpinë e tij në Kaliforni. Mjekët e trajtuan atë duke shpresuar se do të shërohej, por kjo gjë nuk ndodhi. Nuk dihet kur Luke dhe Wendy u fejuan, por ajo që dihet është se çifti zyrtarizoi lidhjen shumë shpejt.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	CAGLIARI-FIORENTINA	2	MONCHENGLADBACH-FREIBURG	1	NICE-TOULOUSE	1

Sahiti: Vëllaznimi synon Superligën dhe Kupën

KF Vëllaznimi është duke treguar një sezon të mirë në Ligën e Parë, kurse Samir Sahiti ka bërë me dije se kuqezinjtë synojnë inkuadrimin në Superligë dhe triumfin në garën e Kupës. "Kemi shumë besim se do të inkuadrohemi drejtpërdrejt në Superligë, por edhe nëse do të mbetemi në barazh nuk është tragjike ngaqë e dimë forcën tonë dhe besojmë se prapë do t'ia arrijmë qëllimit", ka thënë Sahiti

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 MARS - Futbollisti Samir Sahiti të enjten për "Epokën e re" ka thënë se synim i Vëllaznimit është inkuadrimi në Superligë pa pasur nevojë t'i luajë ndeshjet e barazhit. Aktualisht skuadra kuqezi pozicionohet në vendin e pestë në Ligën e Parë dhe ka tetë pikë më pak se skuadra lidere, Vushtrria. "Kemi shumë besim se do të inkuadrohemi drejtpërdrejt në Superligë, por edhe nëse do të mbetemi në barazh nuk është tragjike ngaqë e dimë forcën tonë dhe besojmë se prapë do t'ia arrijmë qëllimit", ka thënë Sahiti.

Synimet e Vëllaznimit të Gjakovës nuk janë të mëdha vetëm në kampionat, por edhe në Kupën e Kosovës ku janë kualifikuar deri në gjysmëfinale. Sahiti ka thënë se fillimisht synohet triumfi ndaj Trepçës '89 dhe kualifikimi në finale e më pas edhe luftimi për trofeun që e dërgon skuadrën fituese në garat e Ligës së Evropës. "Në gjysmëfinale të Kupës përballemi me skuadrën e Trepçës '89 dhe këtë skuadër e respektojmë shumë, por Vëllaznimi nuk ka frikë dhe hyjmë në çdo ndeshje për fitore. Synimet i kemi të mëdha si në kampionat, po ashtu edhe në Kupë. Fillimisht synojmë finalen, pastaj të shpallemi edhe fitues. Do të ishte diçka e bukur për tifozët kuqezi dhe qytetin e Gjakovës të ktheheshim në Superligë dhe ta fitonim Kupën", ka shtuar Sahiti.

Në ndeshjen e fundit në Ligën e Parë, Vëllaznimi triumfoi ndaj Dukagjinit të Klinës (1-0), kurse ndeshjen e radhës e zhvillon ndaj Ramiz Sadikut. Synimi edhe në këtë ndeshje për djelmoshat që drejtohen nga Ismet Munishi janë pikët maksimale. "Në ndeshjen ndaj Ramiz Sadikut, si në çdo ndeshje tjetër, do të hyjmë për fitore ngaqë çdo trepikësh ka rëndësinë e njëjtë si ndaj Dukagjinit apo edhe ndaj Ramiz Sadikut". KF Vëllanzimi në nëntëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara në Ligën e Parë ka regjistruar njëmbëdhjetë fitore, katër barazime dhe katër humbje.

SHKURT

Fenerbahçe interesohet për Muriqin

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi, po shkëlqen këtë sezon në ligën elitare të Turqisë me skuadrën e Rizesporit. Këto paraqitje kanë bërë që interesim për shërbimet e tij të shfaqë Fenerbahçe. Sulmuesi Islam Slimani është lënë jashtë skuadrës, kurse Roberto Soldado është në përfundim të kontratës, prandaj drejtuesit e këtij klubi e dëshirojnë një sulmues të ri. Ish-sulmuesi i Lirisë së Prizrenit ka luajtur 25 ndeshje dhe kontribuoi me dhjetë gola dhe gjashtë asistime.

Marijeta Lekaj përforcon Kosovën

Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll është përforcuar me një hendbolliste cilësore para kualifikimeve për "Euro 2020". Marijeta Lekaj, që po luan me shumë sukses në Kroaci, do të bashkohet me Kosovën që nga aktiviteti i ardhshëm. Lekaj, e lindur në qershor të vitit 1997, është e gjatë 170 centimetra dhe mbulon shumë pozita, ndonëse më së shumti luan si bek. Hendbollistja nga Hasi luan për skuadrën Murvica nga Crikvenica në Superligën e Kroacisë. Në qershor apo në shtator Përfaqësuesja e Kosovës do të nisë me ndeshje kualifikuese për Evropianin e vitit 2020. Në ato ndeshje përzgjedhësi Agron Shabani do të mund të llogaritë edhe në shërbimet e Marijeta Lekajt.

Ndërroi jetë ish-futbollisti i Prishtinës, Sabit Dallku

Të enjten, pas një sëmundje të rëndë, ka ndërruar jetë ish-futbollisti i Prishtinës, Sabit Dallku. Sabiti ka luajtur për Prishtinën në fundvitet '70 dhe në fillim të viteve '80. Sabiti ka qenë mbrojtës me nam i skuadrës më të madhe në vend, Prishtinës. Ka qenë pjesë e gjeneratës e cila pati filluar të krijohet me trajner Ilija Dimovskin, e që pastaj patën arritur majën e futbollit ish-jugosllav. Hapave të Sabitit me shumë sukses kanë ecur edhe dy djemtë, Armendi, tani kapiten i Prishtinës, dhe Ardini, futbollist i Vorskla Poltavës nga Ukraina. Varrimi i Sabit Dallkut bëhet sot më 15 mars me kohë të xhumasë në varrezat e Vushtrrisë.

Challandesi publikoi listën për ndeshjet ndaj Danimarkës dhe Bullgarisë

PRISHTINË, 14 MARS - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Bernard Challandes, ka publikuar emëroren e futbollistëve që do t'i ketë në shërbim për miqësoren kundër Danimarkës më 21 mars dhe për ndeshjen e parë në kuadër të kualifikimeve për Euro 2020 kundër Bullgarisë më 25 mars. Për herë të parë pjesë e Përfaqësueses A do të jetë Florent Hasani, anëtar i deritashëm i U21-shave dhe pjesë e skuadrës hungareze Diosgyori, kurse në emëroren e Challandesit janë rikthyer Bersant Celina dhe Bernard Berisha. Grumbullimi dhe akomodimi i futbollistëve të Kombëtares do të bëhet të hënën, më 18 mars, në hotel "Emerald". Lista e futbollistëve të Kosovës: S. Ujkani, A. Muriq, V. Bekaj, A. Rrahmani, F. Aliti, M. Vojvoda, B. Kololli, L. Paqarada, A. Xhemajli, M. Kryeziu, H. Shala, I. Voca, H. Kryeziu, B. Halimi, V. Berisha, B. Celina, B. Berisha, A. Zeneli, E. Zhegrova, L. Kastrati, F. Hasani, M. Rashica, V. Muriqi, A. Nuhiu.

"Epokën e re" për fitore ndaj "Infokusi"-it

Prishtinë, 14 mars - Ekipi lider në Media Ligë, "Epoka e re", pas barazimit në derbin ndaj "Media Works"-it, sonte (e premte) kërkon fitoren në përballje me "Infokusi"-n, e cila zhvillohet nga ora 18:50. Në ndeshjen e parë fitore të vështirë kishte shënuar "Epoka e re" me rezultat 3-2, por forma e mirë e "Infokusi"-t në ndeshjet e fundit bën që kjo përballje të jetë derbi i xhiro së 18. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të "Media Works"-it dhe "InfoKosova & PrishtinaPost"-it, kurse "Klan Kosova" do të luajë ndaj "Lajmi.net". Përballjet e tjera të kësaj xhiroje janë "Gazeta Zëri"-"Telegrafi", "D+"-Ora Info", "Gazeta Metro"-"Gazeta Blic", "Kallxo.com-"RTK", KosovaPress"-"RTV Dukagjini".

Panucci publikon listën për ndeshjet ndaj Turqisë dhe Andorrës

TIRANË, 14 MARS - 22 dhe 25 mars janë datat kur Shqipëria përballet me Turqinë dhe Andorrën. Nisin kualifikueset për "Euro 2020" dhe të gjithë presin që kuqezinjtë të jenë tjetër skuadër nga ajo e Ligës së Kombeve. Së fundmi është zbardhur edhe lista e lojtarëve që trajneri Christian Panucci do të ketë nën urdhra për këto dy përballje. Ka risi dhe lojtarë që nuk janë grumbulluar. Zgjedhjet janë të italianit, përgjegjësitë po të tijat. Në listë risia është Kristi Qose, i cili është ftuar pesë vjet më parë nga Ganni De Biasi. Rikthehen të dëmtuarit, Armando Sadiku dhe Amir Abrashi. Odise Roshi ka pak ditë që ka nisur stërvitjen, por mbetet jashtë për këto dy ndeshje. Kapiteni Mërgim Mavraj mungon, pasi me Skocinë u ndëshkua me karton të kuq dhe është i pezulluar. Kastriot Dermaku është mbrojtësi që mbetet jashtë. Naser Aliji, që tanimë po luan rregullisht te Dinamo e Bukureshtit, është ftuar sërish. Lajm i mirë edhe ftesa për Kristal Abazajn, që tek Osijeku ka kapur drejtpërdrejt formacionin. Grazda është "befasia", pasi ende nuk ka luajtur pas dëmtimit që pësoi në janar. Gjithsesi ai është stërvitur normalisht, kurse bie në sy mungesa e Rey Manajt.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

E. Berisha, A. Hoxha, Th. Strakosha, A. Ajeti, N. Aliji, I. Balliu, E. Binaku, B. Xhimshiti, E. Hysaj, A. Ismajli, E. Mihaj, F. Veseli, A. Abrashi, M. Basha, E. Kaçe, A. Lila, L. Memushaj, K. Qose, T. Xhaka, K. Abazaj, B. Balaj, E. Grezda, A. Sadiku, M. Uzuni.

Golden State mposhti Houstonin

HOUSTON, 14 MARS - U luajtën gjashtë ndeshje në ligën më të fortë të basketbollit në botë, NBA. Ka fituar Golden State Warriors në rrugën për të siguruar një biletë për në "play-off". Ka qenë mbrëmja e "luftëtarëve", të cilët ia kanë dalë të triumfojnë në "Toyota Center", edhe pse me vetëm dy pikë më shumë se vendësit e Houston Rocketsit. Rezultati përfundimtar është fiksuar në shifrat 106-104. Perioda e parë dhe e tretë ishin vendimtare për fituesit. Basketbollisti më produktiv në këtë ndeshje ishte ai i Warrirosit, Klay Thompson, që realizoi 30 pikë. Me 27 pikë u ndal në këtë ndeshje DeMarcus Cousins. Te Houston Rockets spikati i zakonshmi James Harden, që regjistroi "double-double", falë 29 pikëve dhe 10 asistimeve. Pas këtij suksesi, Golden State mbetet lider i Konferencës Perëndimore, ndërsa Houstoni e shikon veten në vendin e katërt.

REZULTATET

Houston Rockets - Golden State W.	104-106
Oklahoma - Brooklyn	108-96
Washington - Orlando	100-90
Atlanta - Memphis	132-111
Miami - Detroit	108-74
Phoenix - Utah	97-114

Solskjeri kërkon katër përforcime në United

Katër blerje të rëndësishme për ta forcuar skuadrën dhe për t'i ngushtuar dallimet me rivalet e Manchester Cityt. Sipas "Daily Mirror", Ole Gunnar Solskjaer u ka kërkuar drejtuesve të Manchester Unitedit katër emra të rëndësishëm në afatin kalimtar të verës. Tre nga ta janë Alderweireld (Tottenham), Sancho (Dortmund) dhe Coutinho (Barcelona).

SHKURT

Beckenbaueri e dëshiron Kloppin në Bayern

Ish-presidenti i Bayern Munchenit dhe legjenda e Gjermanisë, Franz Beckenbauer, dëshiron që ta shohë Juergen Kloppin në postin e trajnerit të skuadrës "bavareze" në një të ardhme të afërt. "Juergen Kloppi te Bayerni do të ishte gjë e madhe", ka thënë Beckenbauer. Kjo deklaratë e legjendës gjermane erdhi pasi Jurgen Kloppi me skuadrën e Liverpoolit e eliminoi Bayernin nga Liga e Kampionëve.

Messi lavdëron Ronaldon

Leo Messi e ka lavdëruar rivalin e tij më të madh, Cristiano Ronaldon, për formën e mirën që tregoi në ndeshjen ndaj Atletico Madridit. "Ajo që bëri Ronaldo dhe Juventusi ishte impresiononte dhe e jashtëzakonshme. Mendoja se Atletico do të luante më fort dhe më mirë, por nuk ndodhi kështu. Ronaldo pati një natë magjike duke shënuar tri gola", ka thënë Messi.

Vetteli: Dua ta thyej dominimin e Hamiltonit dhe të Mercedesit

Formula 1 është gati ta ngrehë siparin e sezonit të ri, që do të startojë me Çmimin e Madh të Melbournit në Australi, i planifikuar për këtë të diel. Skuadrat kanë mbërritur tashmë në kontinentin e largët, për të qenë gati për provat e lira, që do të nisin nesër, ndërsa janë mbajtur edhe konferencat zyrtare për shtyp në prag të fillimit të sezonit. Kështu, gjermani Sebastian Vettel ka lëshuar sërish sfidën ndaj kampionit në fuqi të Botës, Lewis Hamilton, duke thënë se synon ta thyejë dominimin e britanikut dhe Mercedesit në këtë sport. "Jemi përmirësuar krahasuar me një vit më parë, por rruga është e gjatë dhe shpresoj të tregohemi të fortë gjatë gjithë sezonit, për të bërë diçka të madhe. Rivali është pa diskutim Hamilton, që ka fituar në dy vjetët e fundit, por ne kemi kohë që punojmë për ta thyer dominimin e tij dhe të Mercedesit", ka thënë piloti gjerman.

Capello: CR7 i jashtëzakonshëm, Messi është një gjeni

Rivaliteti në mes të Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit është pa dyshim një ndër gjërat më të bukura që ka përjetuar historia e futbollit. Diskutimet se kush është më i miri janë të pafundme, ku së fundmi këtij debati nuk i ka shpëtuar as Fabio Capello. "Ronaldo është një futbollist i jashtëzakonshëm, por Messi është një gjeni. Futbolli ka tre gjeni: Pelen, Maradonën dhe Messin. Ronaldo është shumë i fortë, pasi me të mund të fitosh gjithçka, por Messi është gjeni dhe kjo është diçka tjetër. U përballa me Messin kur ai ishte 16 vjeç dhe isha i mrekulluar. Bëri të njëjtat gjëra që bën sot, por 20 vjet më parë, sepse ai ka lindur i tillë. Një gjeni. Ai shpik gjëra që të tjerët nuk i shohin. Ronaldo e bëri veten kampion, por jo gjeni", ka deklaruar Capello.

Lewandowski kritikon paraqitjen e Bayernit

Sulmuesi i Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, është shprehur i pakënaqur me mënyrën se si luajti Bayerni në të dyja ndeshjet ndaj Liverpoolit. Sulmuesit polak nuk i ka pëlqyer fakti se skuadra e tij ishte shumë e tërhequr dhe rastet për shënim ishin të pakta. "Tentuam të ushtronim presion ndaj Liverpoolit por, fatkeqësisht, ishim shumë të dobët në sulm. Shumicën e rasteve ishim dy kundër katërve dhe s'mund të bënim asgjë. Pata disa duele, por e kisha shumë të vështirë t'ia dilja i vetëm, sepse kur ke përballë 2-3 mbrojtës të fortë nuk ia del dot. Ne e dinim se do të ishte një ndeshje e luftuar, por në të dyja ndeshjet luajtëm shumë të tërhequr. Nuk tentuam kurrë të merrnim iniciativë dhe të vinim kundërshtarin në rrezik, pra të ishim Bayerni. U mbrojtëm shumë dhe nuk arrij ta kuptoj arsyen", ka thënë Lewandowski.

Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA JONË .... LILA	BYREKU ME LAKRA TË GRIRA	VEGËL MUZIKOR, BORI	LLOJ PAPAGALLI	SILIC	NJËSIA PËR MATJEN E FUQISË SË RRYMËS ELEKTRIKE	LUMË NË SHBA E KANADA ME UJËVARA ATRAKTIVE	INTER	EPOKA E RE	BASHKË, ME (bised.)	MIMOZA MUSTAFA
QYTET NË SHQIPËRI									TIM MONTGOMERI / NË KËTË MOMENT		
DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË								AKTORI ... HANKS / FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO			
KRIMB TOKE QË VIHET NË MAJË TË GREPIT PËR TË NDJELLË PESHKUN					PRIMITIV / FSHATI KU NDODHET AEROPORTI I TIRANËS						MODEJA & AKTORJA E FAMSHME PARAGUAIANE RIQUELME
DUKATI				ISH PRESIDENTI AMERIKAN RONALD / BASHKËT.						BASHKËT. / DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR	
EPOKA E RE	ZANORE / EMËR MASHKULLI MYSLIMAN		TRUP GJEOMETRIK / USHTRIA								
LLOJ PAPAGALLI				AKTORI I FAMSHËM ROBERT / I AFROVA (bised.)					EMI ROSUM / PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.)		
KLUB I YNI FUTBOLLI						SHTET I LASHTË NË AZI (pashq.) / ZANORE					
EPOKA E RE	SHPËRTHIM I FUQISHËM	SHKENCA MBI PAQEN	ISH FUTBOLLISTI KROAT .... KOVAÇ (BAYERN MUNICH)		FUTBOLLISTI GRANIT / BRITMË E LOPËS	ILIRIDA / ZANORE		VËLLIMI, SASIA / TENISTJA JUSTINE					EMOCIONOH-EM; MË LË MBRESA DIÇKA; MALLËNGJ-EHEM	RADIOLOGY INFORMATION SYSTEM / LËRE (bised.)			
MAKINË QË SHNDËRRON ENERGJINË MEKANIKE NË ENERGJI ELEKTRIKE							FUTBOLLISTI MARTINEZ (B. MUNICH) / FLETORE PËR SHËNIME DITORE					QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI / PËRGJIGJE NË TELEFON					
KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON (shq.)						HAPËSIRË E MADHE UJI (shq.) / TËRËSIA E NJOHURIVE TË FITUARA; DIJE					KËNGËTARJA E FAMSHME FRANKLIN / AVULL QË DEL NGA TOKA						ISH KËNGËTARJA ..... BITRI
QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE					FUTBOLLISTI ANTONIO (UDINESE) / FUTBOLLISTI YNË FREDERIK (MAN. UTD.)									SHKRONJË GREKE / ANNA MICHELLE			
"N" në mes të dy "O"				QYTET NË KOSOVË (pashq.) / PUNË A VEPËR MIZORE; KËRDI					JURIST QË JEP NDIHMË PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË / I ÇEL							BASHKËT. / LIGJI, KANUNI (vjet.)	
SËMUNDE E RËNDË NGJITËSE (pashq.)			GAZ NATYROR I THJESHTË, PA NGJYRË E PA ERË (shq.) / SHTET NË EVROPË							ZANORE / FUTBOLLISTI ..... MEHA (shq.)		ERMELINDA MEKSI / PRINC ARAB			NORA ISTREFI / KËNGËTARI ..... ARIFI (shq.)		
I ÇMENDUR, I TRANUAR								BANESË E VEÇANTË E GRAVE TË SHEIKËVE / GRYKA E VULLKANIT						NË DITËN E SOTME / I GJALLË E I SHKATHËT; ENERGJIK			
